



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.800/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.800/2023 të datës 01.06.2023 të ankuesit ne adresë banimi: Rruga Komuna e Prishtinës, kundër Njoftimit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 24.05.2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar, ankesa A.nr.800/2023 e datës 01.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 18.04.2023 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik" në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin me numër të protokollit 2188 e datës 24.05.2023 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka parashtruar ankesë me datë 01.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokollit: 4560/2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Vlerësues nuk kishte kapacitetin e duhur profesional, e arsimor në zhvillimin e procesit intervistues, e po ashtu vlerësimi nuk ka qenë objektiv, i paanshëm, meritore dhe në përputhshmëri me aktet ligjore, ashtu që nuk ka arritur të sqaroj se si është arritur deri tek poentimi, ndërsa ka kërkuar që Këshilli të aprovoj ankesën dhe të detyroj Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të sistemoj ankuesin në pozitën e aplikuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 06.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 06.06.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë e cila në Këshill është regjistruar me numër prot:800/2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4560/2023 e datës 01.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV e ankuesit; Njoftimi i datës 31.05.2023; Njoftimi me numër prot.2188 i datës 24.05.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 24.05.2023; E-mail i dërguar nga SIMBNJ drejtuar A.B e datës 31.05.2023; E-mail i dërguar nga SIMBNJ drejtuar A.B e datës 24.05.2023; E-mail i dërguar nga Burimet Njerëzore të MPJD drejtuar A.B e datës 23.05.2023; Njoftim me numër prot.2021 e datës 11.05.2023; Konkursi i datës 18.04.2023; Dëshmi pune e datës 10.05.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.06.2023; Përgjigja në ankesë e datës 06.06.2023; E-mail i dërguar nga A.B drejtuar Burimeve Njerëzore të MPJD e datës 26.05.2023; E-mail i dërguar nga V.B drejtuar KPMSHCK e datës 06.06.2023; Aplikacioni i ankuesit i datës 10.05.2023 me të gjitha dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes konkursit të datës 18.04.2023 ka shpallur konkursin-lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", në të cilin konkurs sipas shkresave të lëndës konstatohet se kishe aplikuar ankuesi mirëpo sipas Njoftimit të datës 24.05.2023 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së, i njëjti kishte arritur të grumbulloi vetëm 41 pikë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për emërim apo për të qenë kandidati i suksesshëm në procedurë të rekrutimit tek lëvizjet brenda kategorisë sikurse përcaktohet me nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës: *"Kandidati që është vlerësuar me një shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshmërisht."*

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në njoftimin e datës 24.05.2023 përmes të cilit ishte njoftuar ankuesi lidhur vlerësimin e tij nga ana e Komisionit të Pranimin ishte udhëzuar në mjetet juridike sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës sikurse përcaktohet: *"Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual. 2.Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj."*, ndërsa pas kalimit të afatit të përcaktuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së ka nxjerrë Njoftimin e datës 31.05.2023 përmes të cilit konstatohet fakti se procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik" ka përfunduar pa fitues sikurse përcaktohet me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe" konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 01.06.2023 është e palejuar pasi që ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se i njëjti ka parashtruar ankesë të brendshme kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve respektivisht kundër Njoftimit të datës 24.05.2023 sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.800/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

